



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 733/10 prot.

Datë 29.04.2025

V E N D I M

Nr.572/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

Ankimues:

Operatori ekonomik (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK, përfaqësuar nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK me NIPT K91628013D dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Asim Vokshi , Alb building 2t, kati i 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Dibër.

Adresa: Bulevadi “Elez Isufi”, Peshkopi.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK me NIPT K01730502Ë dhe adresë Rruga "Dituria", Zona

Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozet, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.01.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.

II.2. Në datën 21.01.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 17.02.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “Ina”	86.896.059 lekë	skualifikuar
2. BOE “2 N” & “Bonus “	88.196.167 lekë	skualifikuar
3. OE “ Liqeni VII”	98.197.183 lekë	kualifikuar
4. OE “ T &XH”	98.703.306 lekë	kualifikuar
5. BOE “ Aurora Konstruksion ” & “ Desaret Company “	98.989.335 lekë	skualifikuar
6. BOE “ Alko Impex Construction ” & “ Alko-Impex General Construcion “	106.782.755 lekë	skualifikuar
7. OE “Fusha”	109.159.043 lekë	skualifikuar
8. OE “ Leon Konstruksion”	108.918.848 lekë	kualifikuar

II.4 Në datën 10.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Njoftim të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt -shqyrtimi.

II.5. BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion ” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë: “Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Vlerësimi I dokumentacionit per BOE “ALKO IMPEX KONSTRUKSION & Alko impex general construction” eshte bere bazuar ne nenin 88 pika 3 e VKM 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” I ndryshuar, ku citohet: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

1- Bashkimi I Operatoreve ekonomik ka paraqitur per pune te ngjashme kontraten me objekt: Rikonstruksion shkolla fillore “Myrtesa Sala” Bilisht Devoll, e cila eshte ne vleren 106.298.906 lek me tvsh, ku eshte kryer si investim ne nga BOE: ALKO IMPEX KONSTRUKSION & Alko impex general construction”, ku realizimi I punimeve eshte bere 60.19 % nga shoqeria Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION, dhe 39.81 % nga shoqeria ALKO IMPEX KONSTRUKSION. Vlera totale e kontrates pa tvsh eshte

88.582.421 leke. $(88.582.421 \times 60.19 \%) = 53.149.453$ e cila eshte me e vogel se $(118.385.642 \times 50\%) = 59.192.821$, pra operatori ekonomik Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION, I cili ka perqindjen me te madhe ne BOE nuk permbush kushtin e pikes 2.3.1 te DT.

- 2- Bashkimi I Operatoreve ekonomik ka paraqitur per pune te ngjashme kontraten me vlere 46.568.319 leke pa tvsh, ku eshte kryer si investim ne nga BOE: ALKO IMPEX CONSTRUKSION & Alko impex general construction”, ku realizimi I punimeve eshte bere 63.76 % nga shoqeria Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION, dhe 36.24 % nga shoqeria ALKO IMPEX CONSTRUKSION. Ne baze te perlllogarites se vleres se 50% fondit limit operatori ekonomik Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION, nuk permbush kushtin e vleres ne baze te kesaj kontrate, ku dhe operatori ekonomik ALKO IMPEX CONSTRUKSION, nuk permbush kushtin e vleres duke pasur parasysh qe $59.192.821 \times 49\% = 29.004.842$ pa tvsh, dhe $46.568.319 \times 36.24 = 16.876.359$. Bashkimi I operatoreve ekonomik nuk permbush piken 2.3.1 te DT.
- 3- Bashkimi I operatoreve ekonomik nuk ploteson piken 2.3.4, 2.3.6 dhe 2.3.11 sipas natyres zerave te ndarjes se punimeve ne aktmarrveshje, ku qe te dy operatoret ekonomik duhet te plotesojne kerkesat e dokumentave te tenderit sipas nenit 88 pika 3 e VKM 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” I ndryshuar, ku citohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. BOE nuk ploteson kerkesat e kualifikimit profesionale dhe teknike në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në punë, te përcaktuara ne aktmarrëveshje”.

II.6. Në datën 17.03.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5143 dhe me nr. 733/2025 prot, datë 17.03.2025, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK , ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomikë dhe në alternativë me anulimin e procedurës së prokurimit përsa kohë kriteret kualifikuese janë të paqarta dhe krijojnë hapsirë për abuzim në vlerësimin e tyre.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 733/2 prot., datë 18.03.2025.

II.8. Me shkresën nr.733/3 prot., datë 02.04.2025, me objekt “Mbi detyrimin e autoriteti kontraktor për dhënie informacion KPP-së...” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “...Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së,

autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “ Alko Impex Construction ” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues”.

II.8. Më datë 12.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 733/4 prot., datë 14.04.2025, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve, në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar, argumenta të cilat janë paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 113 të LPP.

II.9. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.34/1 prot., datë 12.04.2025, protokolluar me tonën me nr.733/5 prot., datë 15.04.2025, operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr.34 prot., datë 12.04.2025 me objekt “Kundërshtim i ankesës nr.4/2025/5143 lidhur me objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Dibër 2024” të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction”, dokumentat standarte të tenderit të datës 26.07.2024, dokumentat standarte të tenderit të datës 21.01.2025, si dhe shtojcën për modifikim të dokumentave të tenderit të procedurës së datës 21.01.2025.

II.10. Në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk u dërgua informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e këtij të fundit bërë me shkresën nr.733/3 prot., datë 02.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr.733/6 prot., datë 16.04.2025, me objekt “Mbi detyrimin e autoriteti kontraktor për dhënie informacion KPP-së...” iu drejtua përsëri autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “...Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni përsërit kërkesën që autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues”.

II.11. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1277/1prot., datë 16.04.2025 me objekt “Informacion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Dibër2024” ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e KSHA-së nr.1 prot., datë 16.04.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit nr.1 prot., 16.04.2025 të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK), në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor, gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe konkretisht.

III.1.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, *përsa kohë kriteret kualifikuese (duke ju referuar këtu kriterit 2.3.1) janë të paqarta dhe krijojnë hapsirë për abuzim në vlerësimin e tyre*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.3. Në shtojcën nr.1, datë 10.01.2025 me objekt “Për sqarim dhe mofifikim në dokumentat e tenderit me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, publikuar në sistemin e prokurimit publik, pikën 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

b.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose,

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të

një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- ***Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:***

a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;*
- *Kontratë Sipërmarrrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Aktin e kolaudimit; (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- *Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.*

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *vertetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:*
- *Kontrate Sipërmarrrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Aktin e kolaudimit; (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- *Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;*
- *Fatura tatimore të situacionit përfundimtar*

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- *Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;*
- *Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:*

a) *Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe*

b) *Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.*

III.1.4. Në dokumentet e tenderit të publikuar në sistemin e prokurimit publik, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka publikuar specifikimet teknike dhe preventivin me zërat e punimeve të cilat do të realizohen nëpërmjet këtij investimi.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

1. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Ministria e Financave dhe Ekonomisë për operatorin ekonomik “Alko-Impex General Construction” SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale 26 marsi Kavajë” data e fillimit të kontratës 03.12.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 11.09.2020, vlera e realizuar e kontratës xxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” SHPK. Vlerësimi: E Përmbushu PO.
 2. Kontratë pune me nr. 2832/5 prot., datë 11.06.2019 me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale 26 marsi Kavajë” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko-Impex General Construction” SHPK 86.5% dhe “2 T” SHPK 13.5%; dhe autoriteti kontraktor Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me vlerë xxx lekë me TVSh.
 3. Situacioni përfundimtar i punimeve.
 4. Procesverbal kolaudimi me datë 09.11.2020.
 5. Certifikatë e Përkohshme e marrjes në dorëzim
-

1. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK 36.24% & “Alko-Impex General Construction” SHPK 63.76 % për objektin e kontratës “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Irfan hajrullai, peshkopi, bashkia Dibër” data e fillimit të kontratës 23.12.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 08.09.2023, vlera e realizuar e kontratës xxx lekë me TVSh, realizuar nga BOE “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK Vlerësimi: E Suksesshme.
 2. Kontratë sipërmarrje me nr. 5473 prot., datë 25.11.2022 me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9- vjecare Irfan Hajrullai, Peshkopi, Bashkia Dibër” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK 36.24% & “Alko-Impex General Construction” SHPK 63.76 % dhe autoriteti kontraktor Bashkia Dibër, me vlerë xxx lekë me TVSh.
 3. Situacioni përfundimtar i punimeve.
 4. Procesverbal kolaudimi
-

1. Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Devoll për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK 39.81% & “Alko-Impex General Construction” SHPK 60.19 % për objektin e kontratës “Rikonstruksion i shkollës fillore “Myrteza Sala”, Bilisht Devoll” data e fillimit të kontratës 23.12.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 23.02.2024, vlera e realizuar e kontratës xxx lekë me TVSh, realizuar nga BOE “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK Vlerësimi: Shumë mirë.
 2. Kontratë me nr. 3462 prot., datë 17.10.2022 me objekt “Rikonstruksion i shkollës fillore “Myrteza Sala”, Bilisht Devoll” , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK 39.81% & “Alko-Impex General Construction” SHPK 60.19 % dhe autoriteti kontraktor Bashkia Devoll, me vlerë xxx lekë me TVSh.
 3. Situacioni përfundimtar i punimeve.
 4. Procesverbal kolaudimi datë 05.05.2024.
 5. Certifikatë e Përkohshme e marrjes në dorëzim
-

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, , i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.8 Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues BOE “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, *përsa kohë kriteret kualifikuese (duke ju referuar këtu kriterit 2.3.1) janë të paqarta dhe krijojnë hapsirë për abuzim në vlerësimin e tyre*, KPP vëren se në kriterin e veçantë të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar: **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, *lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,*
ose,

a. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë ***të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*** Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit ***në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se në kriterin 2.3.1 kemi dy kritere me të njëjtën reference 2.3.1.a (në fakt në dokumentat e tenderit është 2.3.1.b), Komisioni gjykon se kjo nuk është arsye, e cila përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit. Komisioni konstaton se kriteri 2.3.1 ka të paraqitura të dy nënpikat e tij me të njëjtën shkronjë (b), pra si *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% ... ashtu edhe Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku ...*, por një mënyrë e tillë e të shprehurit/paraqitjes së kriterit është një gabim formal në renditjen e pikave (të dyja pikat janë shprehur “b”), por është e qartë nga përmbajtja që janë dy opsione/kritere të ndryshme, e për rrjedhojë nuk konsiderohet kriter i paqartë dhe të përbejë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit sikurse ankimuesi pretendon. KPP vlerëson se një mënyrë e tillë e paraqitjes së kriterit nuk konsiderohet në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, cka do të përbënte shkak për anulimin pjesërisht të dokumenteve të tenderit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Theksojmë se anulimi i procedurës kryhet për të ruajtur integritetin e një procesi të rregullt të prokurimit, por në rastin konkret nuk ndodhemi në kushtet e anulimit. Anulimi i një procedure prokurimi nuk është i justifikuar nëse përmbatja e kriterit të vleresimit është e qartë. Në rastin konkret, vetëm renditja e paraqitjes së pikave apo shkronjave është jo e saktë apo konfuze, por për sa kohë kjo nuk ndikon në transparencën, barazinë në trajtimin ose rezultatin perfundimtar të vleresimit, nuk përbën shkak për anulimin e procedurës. Akoma më tej operatori ekonomik ka patur mjetin e “Kërkesës për sqarim” sikurse parashikohet në nenin 75 të *lex specialis*, lidhur me këtë paqartësi, pa qene e nevojshme të kërkojë anulimin e procedurës.

Pra, pasaktësia e renditjes së pikave/shkronjave të kriterit 2.3.1, në rastin konkret nuk shoqërohet me paqartësi ose problematika në përmbajtjen dhe kuptueshmërinë e vet kriteit. Për sa kohe kriteret janë të qarta, të kuptueshme dhe të aplikueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë një pasaktësi teknike në renditjen mund të korrigjohet me një sqarim.

KPP gjykon, se anulimi është një masë e fundit që përdoret për parregullsi që cenojnë në mënyrë thelbësore ligjshmerinë dhe integritetin e procesit të prokurimit dhe vetëm në këto raste anulimi duhet të konsiderohet si një masë e justifikuar.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.1.11. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për përmbushjen e kriterit më sipër, si dhe arsyeve të skualifikimit të dhëna nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse

kriteri në fjalë i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje punët e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se, së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohej, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, me një vlerë jo më të madhe se 50 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku **gjatë pesë viteve të fundit**, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Nga verifikimet rezulton, se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje periudhën e kërkuar për realizimin e punëve të ngjashme të kryera më parë nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar sipas parashikimeve të aktit nëligjor më sipër punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku **gjatë pesë viteve të fundit**, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, por ka përcaktuar *punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për anulimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi si dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë, parashikimet e nenit 39, pika 5 të aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet

ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, nuk mund të garantohej një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me punët e mëparshme të ngjashme është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave si dhe në vlerësimin e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta, të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe atë sektorial në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.12. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, ku parashikohet se: *“[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit *“Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet:”* është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe kjo përbën shkak për anulimin pjesërisht të dokumenteve të tenderit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kritere jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues *“Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK* mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga

procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyetimin se: *Bashkimi I operatoreve ekonomik nuk ploteson piken 2.3.4,2.3.6 dhe 2.3.11 sipas natyres zerave te ndarjes se punimeve ne aktmarrveshje, ku qe te dy operatoret ekonomik duhet te plotesojne kerkesat e dokumentave te tenderit sipas nenit 88 pika 3 e VKM 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” I ndryshuar, ku citohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.BOE nuk ploteson kerkesat e kualifikimit profesionale dhe teknike në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në punë,te percaktuara ne aktmarrevshje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën nr.1, datë 10.01.2025 me objekt “Për sqarim dhe mofifikim në dokumentat e tenderit me objekt “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, publikuar në sistemin e prokurimit publik, pikën 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.4, pika 2.3.6 dhe 2.3.11 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë te certifikuar sipas profesioneve, te pakten si me poshte:*

- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit***
- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) arkitekt, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit***
- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) gjeodet, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit***
- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) gjeolog, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit***
- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) hidroteknik, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit***
- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) punonjes **manovratore** te mjeteve te renda, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet*

perkatese, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **4** (kater) punonjes **shofer**, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme),leshuar nga institucionet perkatese, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2** (dy) teknik ndertimi , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme),si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2** (dy) elektrikist , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3** (tre) hidraulik, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3** (tre) punonjes, Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën Qershor 2024 e ne vazhdim ose te paraqitet kontrate kontraktimi sherbimi ku te paraqitet (kontrata/marreveshja e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates, kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme),si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise qe ofron shëbimin për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3** (tre) karpentier, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3** (tre) murator, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **4** (kater) suvatues, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **4** (kater) bojaxhi, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie

Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **4** (kater) Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2** (dy) hidroizolues, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (nje) mekanik, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2** (dy) betonues, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (nje) Teknik ose Specialist IT/ komunikimi /elektronik/informatik per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, dëshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **Muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (nje) saldator, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, dëshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten **Muajin e fundit**

Shënim: Kriteri per piken 2.3.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të 2(dy) punonjës të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi. Për këtë duhet të paraqesë: certifikata trajnimi për “Punimet në lartësi D.P.I., Rënia nga lartësitë, Punimet në lartësi D.P.I. skela, shkallë, skarpate etj” e dhenë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj dhe të figurojnë në listëpagesat **Muajin e fundit**
- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **Muajin e fundit**
(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").
- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës me certifikate PMNZSH ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **Muajin e fundit**
 - Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë se ka të punësuar 1 (një) punonjës të trajnuar/certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”. Për këtë duhet të paraqesë certifikatë trajnimi e dhenë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj.

Shënim: Kriteri për piken 2.3.6 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Në pronësi ose me qera	4
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5 Ton	Në pronësi ose me qera	3
3	Autovinç	Në pronësi ose me qera	2
4	Kamion me kapacitet mbajtes jo më pak se 10 ton	Në pronësi ose me qera	2
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qera	2
6	Autopompe Betoni	Në pronësi ose me qera	2
7	Autobot uji	Në pronësi ose me qera	2
8	Betoniere kantieri	Në pronësi ose me qera	1

9	Kompresor	Në pronësi ose me qera	1
10	Gjenerator	Në pronësi ose me qera	1
11	Depozite uji kapaciteti min 2000 l	Në pronësi ose me qera	2
12	Pompe suvatimi	Në pronësi ose me qera	1
13	Saladtrice	Në pronësi ose me qera	1
14	Fadrome me goma	Në pronësi ose me qera	2
15	Minieskavator	Në pronësi ose me qera	1
16	Rrul	Në pronësi ose me qera	1
17	Fabrike Nyje/Inerte	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	1
18	Fabrike betoni	Në pronësi ose me qera Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	1
19	Cekic Peneumatik	Në pronësi ose me qera	1
20	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qera	2
21	Kontenier ndertimi stacionar	Në pronësi ose me qera	1
22	Skeleri fasade	Në pronësi ose me qera	1000 m2
23	Tokmak	Në pronësi ose me qera	1
Nr	Mjete mbrojtese	Në pronësi ose me qera	Sasia
1	Kokore	Në pronësi ose me qera	80 cope
2	Jelek	Në pronësi ose me qera	80 cope
3	Tabela Sigurimi Teknik	Në pronësi ose me qera	30 cope
4	Fikse Zjarri	Në pronësi ose me qera	5 cope
5	Kuti Ndihme e shpejt	Në pronësi ose me qera	5 cope

Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

- Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për pajisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.

- f) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur fature zhdoganimi/fature tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- g) Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.
- h) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.
- i) Per Fabrikat e prodhimit te betonit /inerteve OE duhet te paraqesin kontratë furnizimi (Kontrata Nateriale e Qerasë/Furnizimit)

Shënim: Shënim: Kriteri per piken 2.3.11 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

III.2.3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK, për përmbushjen të kriterëve të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Kontratë për bashkim të përkohshëm të shoqërive “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK datë 21.01.2025
- Preventivi i punimeve sipas përqindjes së pjesëmarrësve.
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “ Alko Impex Construction” SHPK. Konkretisht, mbështetet tek operatori ekonomik “Arkon Studio” SHPK; në Kapacitetin teknik 2.3.4 staf i kualifikuar dhe 2.3.11 mjete dhe pajisje.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “ Arkon Studio” SHPK se “ si subjekt mbështetës i shoqërisë “ Alko Impex Construction” SHPK deklaron, se nuk ka arsye skualifikimi ose përjashtimi nga procedura me të dhënat në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së dhe do të vendosë në dispozicion Kapacitetin teknik, në zbatimin e këtij projekti në rast, se shoqëria “Alko Impex Construction” SHPK do të shpallet fituese”.
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Arkon Studio” SHPK, si subjekt mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “ Alko Impex Construction” SHPK, për pikën 2.3.4.dhe 2.3.11 të kapacitetit teknik.
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Alko-Impex General Construction” SHPK, të firmosur dhe vulosur ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “ Alko-Impex General Construction” SHPK. Konkretisht, mbështetet tek operatori ekonomik “Agri Consrutction” SHPK; në Kapacitetin teknik 2.3.4 staf i kualifikuar dhe 2.3.11 mjete dhe pajisje.

- Deklaratë e operatorit ekonomik “ Agri Construction” SHPK se “ si subjekt mbështetës i shoqërisë “ Alko Impex General Construction” SHPK deklaroi, se nuk ka arsye skualifikimi ose përjashtimi nga procedura me të dhënat në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së dhe do të vendosë në dispozicion Kapacitetin teknik, në zbatimin e këtij projekti në rast, se shoqëria “Alko Impex General Construction” SHPK do të shpallet fituese”.
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “ Agri Construction” SHPK, si subjekt mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “ Alko Impex General Construction” SHPK, për pikën 2.3.4.dhe 2.3.11 të kapacitetit teknik.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmanjin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.6. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.2.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa

cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. Oferta konsiderohet e vlefshme, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.8. Në nenin 39, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu,

një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.10. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kriteret për kualifikim dhe specifikime teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet të kenë në stafin e tyre specialistë të certifikuar sipas profesioneve përcaktuara në pikën 2.3.4 e 2.3.6, si dhe mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës përcaktuara në pikën 2.3.11, kriteret këto, të cilat konsiderohen të përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK, për përmbushjen të kriterëve të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.3. të këtij vendimi. Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërmbushjen e kriterëve të sipërpërmendura nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, arsyet e skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK , të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit të mësipërme, Komisioni gjykon se, është në kushte të paqarta dhe në pamundësi për të vlerësuar mbi arsyet e skualifikimit të dhënë nga

autoriteti kontraktor, konkretisht në vlerësimin e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse ky i fundit nuk ka dhënë apo evidentuar qartë se cilët prej specialiteteve apo mjeteve e makinerive të kërkuara nuk përmbushen nga ky bashkim operatorësh ekonomikë, duke e vënë këtë të fundit në një pozitë jo të qartë, konfuze dhe jo të argumentuar. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka vënë në pozita të paqarta dhe konfuze edhe operatorin ekonomik ankimes për të argumentuar apo kundërshtuar vlerësimin e dhënë për këtë të fundit për arsyen e skualifikimit, në lidhje me specialitetet apo mjetet e makineritë e kërkuara .

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, sepse secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cili specialist apo mjet e pajisje teknike konkrete nuk përmbushet nga ankimesi (bashkimi i operatorëve ekonomikë Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construction” SHPK) në përmbushje të kriterëve 2.3.4, 2.3.6 e 2.3.11 të përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimes qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 15 pika 1 e ligjit nr. 8480, date 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 15, pika 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.
2. Autoriteti kontraktues të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër..
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera dhe duke dërguar dokumentat e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të mësipërme.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion ” SHPK
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Anila Malaj, në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit të rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK, konkretisht nuk jam dakord lidhur me arsyetimin në pikën III.1.11 e III.1.12, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstrukcion i shkollës 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. Lidhur me arsyetimin e shumicës në pikën III.1.11 e III.1.12 të vendimit gjykoj se, nuk është momenti procedural për tu ndaluar dhe vlerësuar nëse kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 nga autoriteti kontraktor në lidhje punët e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Operatorët ekonomikë të interesuar, përfshi edhe ankimuesin, kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Konkretisht në nenin 110, pika 1 parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Rezulton se ankimuesi është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe afatet e ankimit për dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi për ankimuesin, nisin nga dita e publikimit të tyre dhe mbarojnë në ditën e shtatë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Sa më sipër, vlerësoj se është detyrë e operatorëve ekonomikë të pregatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, përse kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 34 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, **vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstrukcion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.
2. Autoriteti kontraktues të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër..

Anëtar
Anila Malaj

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anetar) në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit të rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK, konkretisht nuk jam dakord lidhur me arsyetimin në pikën III.1.11 , III.1.12 e III.2. e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. Lidhur me arsyetimin e shumicës në pikat III.1.11 dhe III.1.12 të vendimit, gjykoj se: **vlerësimi ex post i përputhshmërisë ligjore të kriterëve të kualifikimit të vendosura në dokumentet e tenderit**, në këtë moment procedural, **nuk është as i justifikueshëm juridikisht dhe as i lejuar nga struktura e afateve të përcaktuara në ligjin e prokurimit publik**. Konkretisht, shqyrtimi material i legjitimitetit të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 – që lidhen me përvojën e mëparshme të ngjashme të operatorëve ekonomikë – nuk mund të kryhet në këtë fazë, për shkak se afati për kundërshtimin e dokumenteve të tenderit ka përfunduar dhe nuk është respektuar nga operatori ekonomik ankimues.

Në përputhje me *nenin 110, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar*, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesë mbi përmbajtjen e dokumenteve të tenderit, **vetëm brenda afatit 7-ditor nga data e publikimit të njoftimit të kontratës** (në rastin e procedurave nën kufirin e lartë monetar) ose **10-ditor në rastet përtej këtij kufiri**. Ky afat është i karakterit prekluziv, pra i tillë që **nëse nuk respektohet, sjell humbjen e të drejtës për të ngritur pretendime të mëvonshme lidhur me përmbajtjen e dokumentacionit të tenderit**.

Në këtë kuptim, një operator ekonomik që merr pjesë në një procedurë prokurimi dhe paraqet ofertën e tij **pa ushtruar të drejtën për të ankimuar kriteret që konsideron të paligjshme ose të paarsyeshme**, konsiderohet, në mënyrë të heshtur, **t'i ketë pranuar ato si të vlefshme**. Kjo rrjedh jo vetëm nga parimi i **sigurisë juridike dhe stabilitetit të procedurës**, por edhe nga **detyrimi i vetë operatorëve ekonomikë për të mbrojtur në kohë interesat e tyre**, duke ndjekur mekanizmat e ankimit të parashikuar në ligj.

Nëse do të lejohej që operatori ekonomik të kontestonte përmbajtjen e dokumenteve të tenderit në fazë të mëvonshme, përfshirë në fazën e shqyrtimit të ofertave apo në fazën e marrjes së vendimit për kualifikim ose skualifikim, do të **cenohej rëndë parimi i sigurisë juridike**, do të krijohej pasiguri procedurale dhe do të bëhej **e pamundur mbrojtja efektive e interesit publik në zhvillimin në kohë dhe me integritet të procedurës së prokurimit**.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor **nuk ka detyrim të rishikojë apo të riargumentojë ligjshmërinë e kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, të cilat nuk janë kontestuar në afatin ligjor**, përderisa ato janë bërë objekt miratimi të heshtur nga pjesëmarrësit në procedurë.

Për rrjedhojë, vlerësoj se shumica e **Komisioni i Prokurimit Publik** në këtë procedurë **nuk ka kompetencë funksionale për të shqyrtuar legjitimitetin e një kriteri të dokumenteve të tenderit në një fazë procedurale të mëvonshme**, nëse ky kriter nuk është kundërshtuar brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020. Interpretimi i kundërt, përveçse do të ishte në kundërshtim me ligjin, do të vendoste precedentin e rihapjes së çdo elementi të dokumentacionit të tenderit në çdo fazë të procedurës, **duke minuar parimin e finalitetit procedural dhe të barazisë ndërmjet operatorëve**.

Për më tepër, është detyrë ligjore dhe profesionale e operatorëve ekonomikë që të hartojnë ofertat e tyre **në përputhje me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit**, për atë kohë sa këto kriterë janë bërë të njohura publikisht dhe **nuk janë kundërshtuar brenda afateve ligjore**. Përndryshe, çdo pretendim i vonuar cenon integritetin e procedurës dhe nuk përbën objekt shqyrtimi të vlefshëm nga autoriteti apo organi ankimor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ekonomikë (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK ankimues **nuk qëndron**.

III.2. Në lidhje me shqyrtimin e pretendimit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “Alko Impex Construction” sh.p.k. dhe “Alko-Impex General Construction” sh.p.k., lidhur me skualifikimin e ofertës së tyre për mosplotësim të pikave 2.3.4, 2.3.6 dhe 2.3.11 të dokumenteve të tenderit – për shkak të mosrespektimit të kërkesave të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përqindjen e ndarjes së punimeve sipas aktmarrëveshjes – vlerësoj si më poshtë:

Sipas nenit 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Ky dispozitiv përbën një normë imperative e cila rregullon mënyrën se si duhet të realizohet **shpërndarja e përgjegjësiave për plotësimin e kriterëve të kualifikimit brenda një bashkimi operatorësh ekonomikë**, në funksion të strukturës së aktmarrëveshjes ndërmjet tyre dhe ndarjes së detyrave sipas natyrës së punimeve.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka konstatuar se anëtarët e BOE-së nuk kanë përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat profesionale dhe teknike përkatëse, në përputhje me natyrën e punimeve që secili prej tyre do të marrë përsipër, sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit të dorëzuar. Mosrespektimi i kësaj ndarjeje përbën **shkelje të parimeve të përgjegjshmërisë individuale të secilit anëtar të BOE-së për pjesën përkatëse të kontratës**, dhe në mungesë të plotësimit të kriterëve për atë pjesë, oferta rezulton e papërputhshme me dokumentacionin e tenderit.

Më tej, është e rëndësishme të nënvizohet se, **sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik dhe parimeve të së drejtës procedurale**, barra e provës për të vërtetuar ekzistencën e një shkeljeje apo të një mosrespektimi të dispozitave ligjore në vendimmarrjen e autoritetit kontraktor, **bie mbi operatorin ekonomik ankimues**. Kjo nënkupton se për të mbështetur vlefshmërinë e pretendimit të tij, BOE ankimues ka për detyrë:

- 1- Të identifikojë me qartësi **çështjen ligjore apo faktike që kundërshton**;
- 2- Të saktësojë **bazën ligjore apo dokumentare** mbi të cilën mbështet pretendimin;
- 3- Të paraqesë **prova, indicie dhe/ose argumente logjike** që krijojnë bindjen se vendimmarrja e autoritetit kontraktor është e pajustificuar apo e gabuar.

Në mungesë të një argumentimi të tillë të plotë dhe të strukturuar, **shqyrtimi i ankimit nuk mund të bëhet mbi supozime**, por vetëm mbi elementë objektivë, të provuar dhe të identifikueshëm nga vetë operatori ekonomik.

Në rastin konkret, BOE ankimues **nuk ka arritur të evidentojë me saktësi faktin apo rrethanën ku mbështet pretendimin e tij për përmbushje të kriterëve**, as nuk ka paraqitur **ndonjë element të ri provues**, i cili të përgënjeshtrojë arsyetimin e autoritetit kontraktor mbi skualifikimin. Thjesht kundërshtimi formal i vendimit, **pa një analizë faktike dhe ligjore të dokumentacionit të dorëzuar dhe të akteve të autoritetit**, nuk përmbush standardin e duhur të një ankimi të argumentuar dhe të mbështetur në ligj.

Bazuar në parimin e **efikasitetit të procedurës së ankimit**, si dhe në funksionin kontrollues të kufizuar të Komisionit në verifikimin e akteve të autoritetit kontraktor në dritën e të dhënave

të paraqitura nga palët, **mungesa e një baze të qartë, të strukturuar dhe të provuar të pretendimit** nga ana e BOE-së bën që ankimi të mos qëndrojë.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe në zbatim të parimeve të **barazisë së trajtimit, proporcionalitetit, transparencës dhe sigurisë juridike**, vlerësoj se **BOE ankimues nuk ka provuar në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse se përmbush kriteret e skualifikuara**, dhe për pasojë, pretendimi i operatorit ekonomik ekonomikë (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK ankimues **nuk qëndron**.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, **vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.
2. Autoriteti kontraktues të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Anëtar
Kreshnik Ternova